



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershore 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E
KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOMUNËN E
PRISHTINËS 2018-2021

Neni 1

Miratohet Vendimi për Planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2018-2021.

Neni 2

Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës, i cekur në nenin 1, është bazuar në Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, e miratuar nga niveli qendror.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2018-2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij plani kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/04-0196795/18 më, 10.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

